



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 03, datë 30.12.2015

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “DEPOZITA
HIDROKARBURE (GAZOIL, BENZINË, SOLAR), NË ZONËN ENERGJITIKE DHE
INDUSTRIALE TË PORTO ROMANOS”, BASHKIA DURRËS

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, e ndryshuar si dhe Vendimit Nr. 877, datë 03.10.2013 të Këshillit të Ministrave “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, me subjekt kërkues “Tirana Bank” sh.a, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Depozita Hidrokarbure (gazoil, benzinë, solar), në zonën energjitike dhe industriale të Porto Romanos, Bashkia Durrës, me subjekt kërkues shoqërinë “Tirana Bank” sh.a.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Njësisë së Qeverisjes Vendore.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETAR I KKT

EGLANTINA GJERMENI

MINISTËRI I ZHVILLIMIT URBAN



DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT